



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, datë 14.10.2020

PËR

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 26.07.2018 TË KËSHILLIT  
KOMBËTAR TË TERRITORIT “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETAJUAR PËR ZONËN E  
RËNDËSISË KOMBËTARE MES LAGUNËS SË KARAVASTASË DHE LUMIT SEMAN”**

Në mbështetje të neneve 7, 9, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 3, datë 28.07.2020 “Për miratimin e nismës për rishikimin e Planit të Detajuar për zonën me rëndësi kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe lumit Seman miratuar me Vendim të KKT Nr. 3 datë 26.07.2018”, me kërkesë të Komitetit të Investimeve Strategjike, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimeve të dokumenteve të mëposhtme, të përmendura në pikën 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të Vendimit Nr. 3, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman”:
  - a) *Plani i Zhvillimit;*
  - b) *Rregullorja e Planit;*
  - c) *Hartat shoqëruese.*
2. Dokumentet e ndryshuara, që i bashkëngjiten këtij vendimi, zëvendësojnë dokumentet e përmendura në pikën 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të Vendimit Nr. 3, datë 26.07.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit të Detajuar për Zonën e Rëndësisë Kombëtare mes Lagunës së Karavastasë dhe Lumit Seman”.




3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

